

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe  
siguria**  
Me zgjidhje

**P10**

Data 16/06/2018

## Detyra 1

(a) Bëni dallimin në mes të termeve të mëposhtme ashtu siç përdoren në SNA 700 *Raporti i auditorit të pavarur mbi pasqyrat financiare*; SNA 705 *Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit të pavarur*; dhe SNA 706 *Paragrafët e theksimit të çështjed dhe paragrafët tjerë në raportin e auditorit të pavarur*, dhe ofroni një shembull se si mund të përdorej secili në praktikë.

(i) Refuzimi i opinion KUNDREJT opinionit kundër

(ii) Paragrafi i theksimit të çështjed KUNDREJT paragrafi i çështjeve tjera

(iii) Raporti i pamodifikuar KUNDREJT opinionit të pamodifikuar. (9 pikë)

(b) Ju jeni menaxher i auditimit të klientit Rapanui Shpk, një kompani që shet mobilje me pakicë. Përmbledhja e shifrave draft dhe të audituara është siç vijon:

	2015 (draft) Milion €	2015 (të audituara) Milion €
Të hyrat (për vitin deri me 31 dhjetor)	45.0	43.0
Fitimi para tatimit (për vitin deri me 31 dhjetor)	2.0	1.5
Pasuritë totale (me 31 dhjetor)	31.0	24.0

Pikat në vijim duhet të konsiderohen gjatë draftimit të raportit të auditimit.

1. Rapanui ShPK merr me qira njërën nga lokalet kryesore nga një kompani që është partneritet me drejtorin ekzekutiv të kompanisë. Rishikimi juaj i kontratës së qirasë tregon se shpenzimi i qirasë së kompanisë Rapanui është përafërsisht €50,000 më shumë se çmimi i tregut sipas 'gjatësisë së krahut'. Rapanui ka refuzuar të shpalojë këtë tranaksion në mes palëve të lidhura në shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017.

2. Rapanui ka një degë të vogël në një shtet të Evropës Lindore. Që nga 1 janar 2017 ligji i këtij shteti nuk lejon bartjen e fitimeve nga dega tek mëma. Si rezultat i këtij ndryshimi ligjor, Rapanui ka vendosur të trajtojë degën në bazë të ekuitetit për këtë vit. Ju jeni i kënaqur me trajtimin kontabël nga kompania dhe me shpalojen e mjaftueshme të bërë në pasqyrat financiare për këtë trajtim.

3. Gjatë auditimit, ju keni zbuluar se stoqet me vlerë përafërsisht €1 milion janë përjashtuar nga pasqyrat financiare të kompanisë. Pas diskutimit me menaxhmentin ju jeni i kënaqur me arsyetimin e menaxhmentit se ky veprim ishte i paqëllimshëm. Gabimi ishte korrigjuar para përfundimit të auditimit.

### **Kërkohe:**

Vlerësoni implikimet e këtyre çështjeve në:

(i) Raportin e auditimit për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017. (14 pikë)

(ii) Vazhdimin e marrëdhënies tuaj me kompaninë Rapanui Shpk. (2 pikë)

**[Total: 25 Pikë]**

## Zgjidhja

### (a)

(i) Mohimii opinion është i përshtatshëm kur auditori vendos se nuk ka evidence të mjaftueshme të auditimit për të arritur në një konkludim mbi pasqyrat financiare. Kjo mund të ndodhë, për shembull, nëse ka një mangësi të mëdha në llogarimbajtje, ose ka shumë transaksione të padokumentuara me para të gatshme.

Në anën tjetër, opinion kundër jepet kur auditori vjen në konkludim bazuar në evidence, se pasqyrat financiare nuk paraqiten drejt dhe sinqert. Kjo zakonisht vjen si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve përhapëse lidhur me si është zbatuar një standard i kontabilitetit, etj

(ii) Paragrafi i theksimit të çështjes përfshihet atëherë kur auditori don ta thekson ndonjë çështje të caktuar (e cila është shpalosur si duhet në pasqyrat financiare) për përdoruesit e pasqyrave financiare. Në praktikë, ky paragraf përfshihet kur ka dyshime mbi aftësinë e entitetit të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, por auditori konkludon se entiteti është në gjendje të vijojë.

Paragrafi i çështjeve tjera përfshihet kur auditori dëshiron t'i referohet ndonjë çështjeje e cila nuk do të mbulohej me modifikimin e raportit të auditorit ose përmes theksimit të çështjes. Për shembull, auditori mund të përdor paragrafin e 'çështjeve tjera' për të treguar se shifrat krahasuese të vitit të mëparshëm nuk janë audituar.

(iii) Një raport i pamodifikuar është raport i plotë standard pa asnjë ndryshim nga raporti standard sipas SNA 700. (l). Opinioni i pamodifikuar i referohet situatës kur nuk ka rezervime në opinionin e auditorit ose nuk ka refuzim ose nuk ka kundërshtim. Një raport me theksim të çështjes ose me paragrafin e çështjeve tjera nuk od të ishte një raport i pamodifikuar por do të ishte opinion i pamodifikuar.

### (b)

1. Sa i përket shumës prej €50,000, ajo është vetëm 2.5% e fitimit para tatimit dhe 0.11% e të hyrave prandaj kjo shumë mund të quhet jomateriale. Mirëpo, ky nuk është tregimi në tërësi. Së pari, edhe nëse nuk do të kishte mbipagesë prej 50,000, ky është një transaksion me palë të lidhura prandaj duhet të shpaloset sipas SNK 24. Çështja do të konsiderohet jomateriale, sipas SNK 24. Vetëm nëse do të ishte jomateriale për të dy palët e transaksionit. Kjo do të ishte e mjaftueshme që të rezervohej opinion me "përveç për".

E dyta, mbipagesa mund të shihet si kompenzim shtesë për drejtorin dhe pasoja në këtë rast do të ishte e dyfishtë. E para, do të duhej të shpallosej si kompanzim i drejtorit në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të bursvae (nëse kompania është e regjistruar) dh e dyta mund të ketë pasoja tatimore.

Në secilin rast, transaksioni dhe vet sjellja e drejtorit do të paraqet pengesë për firmën e auditimit për të vazhduar marrëdhënien me këtë klient.

2. Nga kjo duket se nuk ka nevojë për ndonjë shtesë në raportin e auditimit dhe nuk duket se ka ndikim në marrëdhënien e auditorit në të ardhmen. Nëse kjo do të ishte një degë domethënëse e kompanisë do të kërkohej një paragraf i theksimit të çështjes, por pasi që është një degë e vogël atëherë nuk ka ndonjë pasojë.

3. Duke konsideruar se gabimi ishte korrigjuar pase se pasqyrat financiare të publikohen, është e qartë se nuk ka ndikim në raportin e auditimit pa marrë parasysh që shumta është material (50% e fitimit para tatimit dhe 2.22% e qarkullimit). Sa i përmet vazhdimin të marrëdhënies me klientin, nuk duket se ka ndonjë problem, megjithatë auditori duhet të konfirmoj se si ka ardhur deri te gabimi dhe ndoshta të rivlerësoj rrezikun e kontrollit.

## Detyra 2

Më poshtë janë përshkruar situatat nga pesë klient të ndryshëm të auditimit. Viti financiar për secilin rast është 31 dhjetor 2017.

### Hava Shpk

Hava ndërton dhe operon rrjete të fibrave optik. Gjatë vitit, kompania ka kapitalizuar në mënyre të gabuar një kosto prej €6.1 milion që kanë të bëjnë me riparimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit dhe janë përfshirë si kosto në pasuritë joqarkulluese. Drejtorët kanë refuzuar të bëjnë ndonjë korigjim në pasqyrat financiare për këtë ngjarje pasi që kjo do të shkaktonte shkeljen e kushteve të kredisë nga banka.

Totali i pasurisë së Hava me 31 dhjetor 2017 është €1,050 milion dhe fitimi para tatimi për vitin është €142.6 milion.

### Feneri Shpk

Feneri ka sistemin e vazhdueshëm të stoqeve prandaj kompania nuk bënë numërim fizik të stoqeve në fund të vitit. Me 5 janar 2018, një zjarr shkatërroi regjistrat e stoqeve të kompanisë dhe regjistrat e dërgesave. Stoqet nuk ishin dëmtuar. Nuk kishte ndonjë procedurë alternative të auditimit që mund të kryhej. Kompania ka përfshirë në pasqyra financiare një shifër të vlerësuar të stoqeve prej €500,000. Kjo shifër përfaqëson 5% të pasurive totale të Feneri dhe 20% të fitimit para tatimit.

### Meda Shpk

Meda varet nga mbështetja e vazhdueshme nga banka e saj për të financuar aktivitetet. Kredia aktuale skadon me 30 qershor 2018, edhe pse drejtorët kanë pritur që mund të rinovojnë kontratën për kredi me kushte të ngjashme, ata ende nuk kanë një marrëveshje me bankën. Drejtorët kanë përgatitur parashikimet e parasë së gatshme duke u bazuar në supozimin se kredia do të rinovohet. Këto parashikime tregojnë se kompania do të jetë e aftë të përmbushë obligimet e saj për një të ardhme të parashikueshme. Drejtorët janë pajtuar të përfshijnë një shënim në pasqyra financiare e cila do të shpalos këtë situatë. Raporti i auditimit është planifikuar të nënshkruhet me 31 mars 2018.

### Hasa Shpk

Hasa ka në pronësi një tokë në zonën industriale në Prishtinë e cila ishte blerë për €12,000 në vitin 2001.

Pas një lajmi në media se një tokë e ngjashme në atë zonë industriale ishte shitur për €1,000,000, drejtorët kanë rritur vlerën e tokës në €1,012,000 (kosto plus €1,000,000) sipas raportit të vlerësuesit nga një kompanie vlerësimesh me renome. Pjesa e rivlerësuar mbi kosto është përfshirë në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si "E hyrë tjetër operative". Shuma e korigjimit e tejkalon materialitetit për këtë angazhim.

### Sigurimi Shpk

Sigurimi është një kompani e listuar në bursë e cila prodhon pajisje të sofistikuar ushtarake për ministrinë e mbrojtjes. Pasqyrat planifikohet të nënshkruhen me 6 mars 2018. Gjatë auditimit ju jeni informuar se qeveria ka gjasë të madhe të anulojë planet për përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes për shkak të vështirësive buxhetore. Ju jeni në dijeni që parashikimet e klientit tuaj varen nga kontratat me ministrinë e mbrojtjes lidhur me përmirësimin e pajisjeve ushtarake. Kompania tashmë ka probleme me rrjedhën e parasë dhe rishtas ka aplikuar në bankë për rritjen e kredisë. Menaxhmenti është i sigurt se kompania do të vazhdojë operacionet dhe to të tejkalojë krizën financiare. Nëse është e nevojshme, ata pohojnë se mund të shkurtojnë programin e shpenzimeve kapitale në të ardhmen, kërkojnë financim jashtë-bilancit dhe riprogramojnë kredinë aktuale. Ju jeni shumë skeptik me këto pohime të menaxhmentit.

**Kërkohet:**

(a) Vlerësoni në mënyrë kritike ndikimin e sjelljes së drejtorëve të Hava Shpk në vendimin e firmës tuaj për të vazhduar ose jo të jeni auditor për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017.

(5 pikë)

(b) Në secilën nga pesë situatat më sipër, tregoni nëse duhet të modifikohet raporti i auditimit. Arsyetoni përfundimet tuaja dhe tregoni çfarë modifikimi është i nevojshëm në raportin e auditimit (nëse është i nevojshëm).

(20 pikë)

**[Total: 25 Pikë]**

## Zgjidhja

(a) Drejtorët e Hava Shpk duket se janë të përfshirë në mënaxhim agresiv të të hyrave e ndoshta edhe falsifikim të pasqyrave financiare. Ata janë duke u përpjekur të mos shkelin kushtet e kredisë prandaj në mënyrë të gabuar kanë kapitalizuar shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes në shumën prej €6.1 milion. Shuhma përbën 4.28% të fitimit para tatimit dhe 0.58% të pasurive. Këto shuma normalisht do të konsideroheshin jomateriale por nga rrethanat e skenarit, pra kjo shumë do të shkaktonte shkeljen e kushteve të kredisë, tregon se korrigjimi në fakt është material për kompaninë. Dështimi i drejtorëve të përmbushin kërkesën e auditorëve për të korrigjuar pasqyrat financiare do të thotë se ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur vendosim nëse do të vazhdojmë marrëdhënien tonë në të ardhmen si auditorë.

Ky incident tregon se rreziku i vetëvetishëm do të jetë më i lartë se sa që është vlerësuar fillimisht pasi që ka të bëjë me mënyrën e sjelljes së drejtorëve (dhe ndoshta edhe integritetin e tyre). Fakti se kompania ka shkelur kushtet e kontratës së kredisë mund të rezultojë me vështirësi financiare dhe dyshime lidhur me aftësinë e saj të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë. Ky fakt mund të detyroj drejtorët që të bëjnë diçka të ngjashme edhe vitet në vijim, prandaj ky rrit rrezikun e auditimit.

Ne nuk e dimë saktësisht se si janë kapitalizuar kostot në fillim, ose janë bërë me kërkesë të drejtorëve ose për shkak të ndonjë gabimi në sistemin kontrollit të brendshëm. Në secilin rast ne si auditorë duhet të vlerësojmë se rreziku i auditimit për këtë klient është i lartë prandaj duhet të konsiderojmë nëse mund të vazhdohet ose me më këtë klient në të ardhmen.

### (b) Hava Shpk

Refuzimi i drejtorëve të korrigjojnë pasqyrat financiare do të thotë se raporti i auditimit duhet të rezervohet me 'përveç për' për shkak të mosmarrëveshjes lidhur me zbatimin e standardeve të kontabilitetit. Ky rezervim do të specifikoj shumën e duhur dhe të konsiderohet nëse do të përfshihet paragrafi i theksimit të çështjes për shkak të problemit me vijimësinë (shih a) më sipër.

### Feneri

Stoqet janë material pasi që përfaqësojnë 5% të pasurive totale he 20% të fitimit para tatimit. Mirëpo kjo anomali nuk është përhapëse për pasqyrat financiare. Çështja e këtij rasti është pajmaftueshmëria e dëshmive të auditimit (që i referohemi edhe si kufizim i objektit të auditimit) që paraqitet si rezultat i rrethanave të paparshikuara. Në këtë rast raporti i auditimit duhet të modifikohet me një 'përveç për' - raport me rezervë. Po ashtu duhet të konsiderohet nëse edhe fushat tjera të auditimit mund të ndikohen përfshirë shitjet dhe llogaritë e arkëtueshme për shkak të djegies së flëtdërgesave.

### Meda

Në këta rast raporti i përshtatshëm i auditimit do të ishte raport me paragrafine theksimit të çështjes për shkak të hipotezës së vijimësisë. Kjo për shkak (i) për deri sa ka dyshime për vijimësinë e kompanisë, auditorët janë të kënaqur se kompania megjithatë do të vijojë edhe më tutje dhe ka arritur në këtë konkludim pas ekzaminimit të parashikimit të rrjedhës së parasë. (ii) Një shënim është përfshirë në pasqyrat financiare për të shpjeguar situatën në tërësi.

### Hasa

Nuk ka ndonjë arsytim për kompaninë për ta rritur vlerën e tokës në këtë mënyrë dhe jo duke e rritur zërin 'të hyrat tjera operative'. Ky nuk është një fitim i realizuar dhe nuk mund të përfshihet në fitimet që mund të shpërndahen te pronarët. Kjo shumë e tejkalon materialitetin prandaj duhet të rezervojmë opinionin me 'përveç për'. Nëse konsiderojmë se kjo shumë është fundamentale për pasqyrat financiare atëherë mund të japim një opinion kundër.

### Sigurimi

Vështirësia në këtë rast është se auditorët kanë ardhur në përfundim se kompania nuk është më sipas hipotezës së vijimësisë. Mirëpo drejtorët insistojnë që të përgatisin pasqyrat mbi bazën e hipotezës së vijimësisë. Prandaj nuk ka ndonjë opsion tjetër përveç që të jepet një opinion kundër pasi pasqyrat financiare nuk japin pamje të drejtë dhe të sinqert.

### Detyra 3

Ju jeni senior i auditimit në firmën Hilli. Ju keni marr emialin në vijim:

Për: Seniorin e auditimit

Nga: Menaxheri i auditimit

Përshendetje,

Ashtu siç e keni parë nga orari, ju jeni senior i auditimit të kompanisë prodhuese Zhada.

Auditimi do të filloj të martën e ardhshme. Besoj që e ke vërejtur që takimi për planifikim të auditimit është paraparë për të premten në ora 14:30. Dy nga juniorët e auditimit të përcaktuar për këtë angazhim nuk kanë përvojë të majftueshme. Më poshtë është një përmbledhje e shkurt për kompaninë.

Zhada ka filluar aktivitetet e saj 5 vite më parë duke prodhuar produktin "Makro", një instrument i ri që shpresonin ta shisnin te doktorët, stomatologët dhe spitalet. Kërkesa për produktin "Makro" ka tejkaluar pritjet e kompanisë prandaj kompania nuk ishte në gjendje të prodhonte produkte të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e madhe. Zhada prodhonte "Makro" në pajisjet e njëta në të cilat kishte filluar prodhimin para 5 viteve, por kishte nevojë për pajisje më efikase për të përmbushur kërkesën e tregut. Menaxhmenti i kompanisë vendosi të dizajnojë dhe ndërtojë pajisje të reja prodhuese për shkak se nuk kishte pajisje të përshtatshme në treg për ta prodhuar "Makro".

Në vitin 2014, një seksion i fabrikës ishte dedikuar për zhvillimin e pajisjes së re dhe gjithashtu ishte punësuar personel për këtë qëllim.

Brenda gjashtë muajsh, ishte zhvilluar pajisja me një kosto prej €170,000 dhe ishte futur në funksion. Kjo pajisje e rriti produktivitetin dhe gjithashtu zvogëloj koston e punës në mënyrë domethënëse. Të ndezur nga sukcesi i pajisjes së re, kompania ndërtoi edhe tre makina të llojit të njëjtë me kosto prej €80,000 secila. Të gjitha këto shuma janë materiale në kontekstin e pasqyrave financiare.

Do të doja të përgatitni një memo në të cilën ju i konsideroni pyetjet e mëposhtme.

#### **Kërkohet:**

Përgatitni një memo në të cilin:

- (a) Konsideroni arsyet tjera të cilat mund të shkaktojnë që kompanitë të ndërtojnë vet pasuritë joqarkulluese për përdorim të tyre, përveç faktit që kompanitë e jashtme mund të mos arrijnë të përmbushin kërkesën brenda afatit të caktuar kohor. (3 pikë)
- (b) Këshilloni çfarë kosto duhet të kapitalizohen për pasuritë e vetë-ndërtuara. (4 pikë)
- (c) Diskutoni problemet specifike të auditimit me të cilat mund të ballafaqohet auditori në rastet kur ka pasuri të vetë-ndërtuara. (5 pikë)
- (d) Përshkruani procedurat kryesore të auditimit që duhet të kryhen në rastin e Zhada lidhur me pajisjet e ndërtuara që ishin përdorur në prodhimin e "Makro" (6 pikë)
- (e) Diskutoni se si duhet të vendos auditori lidhur me përshtatshmërinë e përfshirjes së shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit në koston e pasurive të vetë-ndërtuara.

(5 pikë)

Formati dhe prezentimi (2 pikë)

**[Total: 25 Pikë]**

## Zgjidhja

(a) Kompania mund të ndërtojë pasuritë për përdorim të vet në raste kur don ti shfrytëzojë resurset e papërdorura siç janë punëtorët apo pajisjet. Në disa raste pasuritë vet-ndërtohen për të kursyer në kosto. Në raste të tjera ka pasuri që kërkojnë njohuri, aftësi dhe talent i cili nuk mund të gjendet diku tjetër. Gjithashtu ka raste kur kompania don ta ruaj procesin e prodhimit të ndonjë produkti të caktuar si fshehtësi afariste.

(b) Kostot të cilat duhet të kapitalizohen për pasuritë e vetë-ndërtuarapërfshijnë materialet direkte dhe indirekte, puna direkte dhe indirekte që mund të indentifikohen me procesin e ndërtimit. Të gjitha kostot direkte që identifikohen me ndërtimin duhet të kapitalizohen. Shembuj të kostove përfshijën licencat, lejet, zhvlerësimi i pajisjeve, sigurimi dhe ngarkesat e ngjashme.

(c) Ekzistenca e e pasurive domethënëse të vetëndërtuara e rrit rrezikun e auditimit në disa mënyra:

1. Për shumicën e entiteteve, pasuritë e vetëndërtuara ndodhin njëherë ose shumë rrallë. Prandaj këto mund të mos jenë të mbuluara si duhet me procedura të kontrollit të brendshëm.
2. Kostimi i pasurive të vetëndërtuara ka gjasë të jetë kontabilitet kompleks menaxherial dhe entitetet mnd të mos kenë sisteme për të grumbulluar dhe raportuar këto të dhëna.
3. Ndonjëherë është shumë e vështirë të përcaktohen me saktësi të gjitha kostot që duhet të përfshihen në pasuritë e vetëndërtuara, kjo sidomos është çështje e vështirë me kostot indirekte dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit.
4. Po ashtu gjithmonë ka dyshime që kompanitë mundohen të kapitalizojnë shpenzime për të rritur fitimet (ka pasur raste të mashtrimeve të tilla).
5. Përcaktimi i shkallës së kompletimit të pasurive të vetëndërtuara mund të jetë problematik për auditorin prandaj ai duhet të mbështetet në vlerësues të pavarur. Mënyra e qasjes së auditorit do të varet nga vlerësimi i rrezikut të auditimit dhe materialiteti.

(d) Llojet e testeve:

1. Konfirmoni vendimin për të ndërtuar vet pasuritë me procesverbalët e takimit të bordit për autorizim.
2. Përputhni një mostër të materialeve me fatura
3. Rishikoni buxhetet për kapitalizim. Krahasoni me kostot aktuale dhe diskutoni diferencat me menaxhmentin.
4. Përputhni normat e interest sipas kushteve të kredive (nëse ka) sipas SNK 23.
5. Përputhni periudhën e kapitalizimit duke iu referuar datës së përfundimit të ndërtimit të makinerive.
6. Rishikoni listën e zërave të kapitalizuar për të konfirmuar natyrën e tyre.
7. Rishikoni listën e riparimeve dhe mirëmbajtjes për ndonjë element i cili do të duhej të kapitalizohej.

(e) Parimi bazë është se çfardo rritje në shpenzimet e përgjithshme të prodhimit i shkaktuar nga vetëndërtimi i pasurive, duhet të kapitalizohet. Këto kosto nuk do të kishin ndodhur nëse pasuria nuk do të ishte ndërtuar. Nuk është e përshtatshme të rritet kosto e mallrave të përfunduar me kosto të cilat nuk ka ndodhur në prodhimin e tyre dhe të cilat nuk kishin ndodhur nëse një pasuri nuk ishte vetëndërtuar.

Mirëpo, nëse kostot totale të pasurive të vetëndërtuara janë tepërcë të përdorimit të tyre ekonomik dhe biznesor, kostot e tepërta nuk do të duhej të kapitalizoheshin por duhet të regjistrohen si humbje.



#### Detyra 4

(A) Klineti juaj i auditimit "M" Shpk është një prodhues i madh farmaceutik. Kompania ka një pjesë të konsiderueshme të tregut të barit paracetamol që shitet me emrin M-paracet. Së voni, një numër i madh i konsumatorëve kanë kërkuar ndihmë të mjekut për shkak të efektit nga M-paracet. Është zbuluar se kjo kishte ndodhur për shkak se përbërja gjatë prodhimit ishte ndryshuar me qëllim.

#### Kërkohet:

Nga informatat e ofruara për kompaninë M:

- (a) Duke supozuar se hipoteza e vijimësisë nuk është problematike, identifikoni tri llogari të pasurive që mund t'i ekspozohen rrezikut. (3 pikë)
- (b) Për secilin nga këto 3 llogari të identifikuar:
- (i) Ofroni një analizë të shkurtër pse është llogari me rrezik;
  - (ii) Tregoni pohimin relevant në të cilin duhet të fokusohet puna e auditimit; dhe
  - (iii) Ilustroni një test të detajeve i cili duhet të kryhet për të grumbulluar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me pohimin e identifikuar nën (b) më sipër. (12 pikë)
- (c)
- (i) Identifikoni një llogari të pasqyrës së të ardhurave i cili NUK është i lidhur me llogaritë e identifikuar më sipër;
  - (ii) Ofroni një analizë të shkurtër pse është llogari me rrezik;
  - (iii) Tregoni cili pohim është relevant për atë llogari me rrezik (3 pikë)
- (B) Një klient tjetër i auditimit, një bankë e madhe, ka marrë një vendim strategjik për të racionalizuar aktivitetet operative të saj duke mbyllur një numër të degëve të bankës gjatë vitit të ardhshëm financiar. Ju keni identifikuar llogarinë "provizionet për punëtorët e larguar" si llogari me rrezik të lartë për vitin aktual financiar. Ju keni vendosur që puna e auditimit të fokusohet në pohimet e plotësisë dhe vlerësimit.

#### Kërkohet:

Për secilin nga pohimet, plotësia dhe vlerësimi:

- (a) Analizoni shkurtër pse është pohim kyç; dhe (4 pikë)
- (b) Përshkruani nga një procedurë thelbësore për të grumbulluar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për këto dy pohime. (3 pikë)

**[Total: 25 Pikë]**

## Zgjidhja

### a) Llogaria e pasurive

1. Stoqet

### b) i) Shpjegimi

Sigurohu se të gjitha stoqet e tërhequra nga tregu janë sjellur në vlerë zero

### b) ii) Pohimi

Vlerësimi

### Testet

Identifikoni të gjitha stoqet që kanë të bëjnë me periudhën e helmimit dhe sigurohuni se janë shlyer ose sjell në vlerën zero

2. Llogaritë e arkëtueshme

Ose  
E pamundur të shiten stoqet për shkak të publicitetit të keq  
Konsumatorët mund të mos pajtohen me kthimet e stoqeve dhe mund të refuzojnë të paguajnë për mallrat jashtë periudhës së ngjarjes

ose  
Vlerësimi

Vlerësimi

ose  
Përcaktoni nëse stoqet duhet të shlyhen ose të sjellen në VNR  
Rishikoni vjetërsinë e LLA të kundërshtuara.  
Rishikoni korrespondencat, bëni pyetje, rishikoni inkasimet e mëvonshme për të siguruar se shumat e dyshimta duhet të provizionohen.

3. Emri i brendit

Tërheqja e shitjeve dhe mallrave mund të ketë efekt afatgjatë mbi emrin e kompanise dhe shitjet në të ardhmen prandaj duhet të konsiderohet vlera e brendit

Vlerësimi

Sigurohuni se të gjitha shitjet e tërhequra janë regjistruar. Gjurmoni notat e kreditit për stoqet dhe LLA për shitjet e tërhequra.  
Përcaktoni ndikimin e mundshëm të shitjeve në të ardhmen duke diskutuar me menaxhmentin, opinionin nga ndonjë vlerësues i pavarur dhe përcaktoni nëse emri i brendit duhet të sjellet në vlerë tjetër më të ulët.

c)

**Llogaria e shpenzimeve**  
Kosto e padive (kosto ligjore dhe/ose kosto lidhur me helmimin e konsumatorëve)

Ose

Kosto e tërheqjeve të produkteve nga tregu

Ose

Kosto e largimit ngapuna të punonjësve

Ose

Kostot e promovimit dhe reklamimit që mund të jenë kapitalizuar më herët

**Shpjegimi - pse rrezik**

Ka gjasë të madhe që konsumatorët e helmuar do të padisin kompaninë duke kërkuar komenzim për kosto spitalore si dhe humbje të të hyrave

Ose

Këto kosto ka gjasë të jenë të mëdha

Ose

Mbyllja e përkohshme e fabrikave

Ose

Reklamat e parapaguara lidhur me produktet që janë tërhequr nga tregu

**Pohimi**

Plotësia

Ose

Plotësia

Ose

Plotësia

Ose

Plotësia

(B)

**Pohimi**

Plotësia

Vlerësimi

**Pse është pohim kyç**

Duhet të sigurohemi se të gjithë të punësuarit dhe kostot e tyre përkatëse përfshihen në provizione

Dhet të sigurohemi se të gjitha kostot janë regjistruar me shuma të sakta. Llogaritjet ka gjasë të jenë komplekse duke u siguruar se

**Testet**

Përzgjidhni një mostër të të punësuarve nga lista e pagave dhe ndjekini deri në llogaritë e provizioneve  
Përzgjedh një mostër të të punësuarve dhe kontrolloni arsyeshmërinë e kostove të largimit nga puna të të punësuarve dhe ndjekni deri te dokumentet mbështetëse, siç janë kontratat e punës, etj.